

VENDIM
Nr.414, datë 11.7.2007

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË
BASHKISË LEZHË TË QARKUT TË LEZHËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të bashkisë Lezhë, të qarkut të Lezhës, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të kësaj bashkie, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 59 (pesëdhjetë e nëntë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 291 (dyqind e nëntëdhjetë e një).

4. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia e Lezhës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Lezhë
Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
6,107-113, 115-131, 133-137, 141, 142, 266, 289, 290	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
24-30, 33-37, 40	Monumente historike e kulturore dhe buste me interes vendor	Në pronësi
11-22	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
42, 45, 46	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
143-168	Prona që përdoren për strehim dhe mbrojtjen civile	Në pronësi
72-98, 169-208, 211-234, 251-258, 286, 288	Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte sip. të gjelbëruara) dhe shërbime publike	Në pronësi
99-102	Varrezat publike	Në pronësi
69-71	Troje dhe hapësira	Në përdorim
103-105	Prona që përdoren për realizimin	Në pronësi

	e funksioneve sociale	
5, 260, 2, 261, 3-261, 6, 261, 9-261, 16, 262- 262, 8, 262, 10-262, 12, 262, 15, 262, 16, 264, 265, 287, 291	Prona që përdoren në fushën administrative	Në pronësi